



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:023132
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485091

Ac.nr.1891/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit F. A. nga Fshati P., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit, av. V. M. nga Ferizaji, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve ‘Scardian’, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M. B. dhe Kompania e Sigurimeve ‘Elsig’ ,me seli në Prishtinë, te cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson V. B., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e të paditurave, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, , Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.327/2020 datë 31.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pa themelta ankesat e të paditurave Kompania e Sigurimeve ‘Scardian’, me seli në Prishtinë, dhe Kompania e Sigurimeve ‘Elsig’ ,me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.327/2020 datë 31.12.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.327/2020 datë 31.12.2021, ka vendosur:
I. PJESËRISHT aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. A., e parashtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ‘S’, me seli në Prishtinë dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve ‘S.’ me seli në Prishtinë që paditësit F. A. t’ia paguaj shumat siç vijo: për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 2800 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë 4200 euro ,për shëmtim trupor 2100 euro, për frikën e përjetuar ,shumën prej 2450 euro, të gjitha këto

me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimi 31.12.2021 e deri në pagesën definitive ,për shpenzime shërimit 81,06 euro, për ushqim të përforcuar 210 euro ,për ndihmën e personit të tretë 238 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis 14.02.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

PJESËRISHT aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. A., e parashtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E. ", me seli në Prishtinë dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E. " me seli në Prishtinë që paditësit F. A. t'ia paguaj shumat siç vijo: për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 1200 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë 1800 euro ,për shëmtim trupor 900 euro, për frikën e përjetuar ,shumën prej 1050 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimi 31.12.2021 e deri në pagesën definitive, për shpenzime shërimit 37.74 euro, për ushqim të përforcuar 90 euro ,për ndihmën e personit të tretë 102 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis 14.02.2020 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "S. " me seli në Prishtinë që paditësit F. A., në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguaj shumat si në vijim: për seancën e datës 07.04.2021 shumën prej 270.40 euro, për 4 seanca gjyqësore shumën prej 1135.68 euro, për përpilimin e padis 156 euro, për ekspertizë mjekësore 212.10 euro, për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë 109.20 euro, në emër të taksës për padi 28.70 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "Elsig" me seli në Prishtinë që paditësit F. A. ,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguaj shumat si në vijim: për 4 seanca gjyqësore shumën prej 486.72 euro, për ekspertizë mjekësore 90.90 euro, për përpilimin e precizimit të kërkesëpadisë 46.80 euro, në emër të taksës për padi 12.30 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Refuzohet si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit F. A. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Scardian" me seli në Prishtinë që paditësit F. A. t'ia paguaj shumat siç vijo: për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 1120 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë 2450 euro ,për shëmtim trupor 3500 euro, për frikën e përjetuar ,shumën prej 2800 euro, për shërim në vendet klimatike 154 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis e deri në pagesën definitive.

REFUZOHET si e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditësit F. A. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Elsig" me seli në Prishtinë që paditësit F. A. t'ia paguaj shumat siç vijo: për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 480 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësorë 1050 euro, për shëmtim trupor 1500 euro, për frikën e përjetuar, shumën prej 1200 euro, për shërim në vendet klimatike 66 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga dita e parashtrimit të padis e deri në pagesën definitive.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura Kompania e Sigurimeve “Scardian” me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu kundër këtij aktgjykimi, e paditura Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit që ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar dëmin material në tërësi dhe gjykuar dëmin jo material duke e vlerësuar secilën rrethanë veç e veç, apo të njëjtin ta prishë dhe lëndën ta kthen në gjykatën e shkallë së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Paditësi ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurave, duke propozuar që të refuzohen ankesat e të paditurave në tërësi si të pa bazuara dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat janë të pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi F. A. nga Fshati Pozheran, Komuna e Vitisë, me datën 14.02.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “Scardian”, me seli në Prishtinë, dhe Kompania e Sigurimeve “Elsig”, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të cilën kërkesë e ka precizuar me parashtrësën e datës 13.07.2021, me kërkesë si në precizimin e dorëzuar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.327/2020 të datës 31.12.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Gjykata e ka detyruar të paditurën Kompania e sigurimeve “Scardian” që paditësit në emër të dhimbjes fizike, frikës, shëmtimit, zvogëlimit të aktivitetit jetësorë t’ia paguaj shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye: Nga konstatimi dhe mendimi ekspertit të Komunikacionit B. L., i datës 17.11.2021, si dhe mendimi plotësues lidhur me ekspertizën e aksidentit të Komunikacionit e datës 19 nëntor 2021 gjykata ka vërtetuar se deri te aksidenti i sipër përmendur ka ardhur për shkak të lëshimeve primare [kryesore] të shoferit të kamionetes “A” të markës Nissan me veprimet e tij: kthim majtas i pasigurte dhe i palejuar [në vijë të plotë], mos respektimi i përparësisë së kalimit ndaj shoferit të automjetit B në përballë kalim. pra nga gjendja e vërtetuar rezulton se kontributi i të siguruarit të të paditurës “Scardian” në aksidentin në fjalë ishte në shkallën prej 70 %. Kurse gjykata nga konstatimi dhe mendimi i ekspertëve mjekësore Dr. sci G. H. neuropsikiatër dhe Dr. Xh. S. ortoped traumatolog ka konstatuar se paditësi si pasojë e

aksidentit të sipër përmendur ka pësuar dëm jomaterial në formë dhimbjeve fizike, frikës, shëmtimit, zvogëlimit të aktivitetit jetësorë ashtu siç është përshkruar në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Kurse e paditura KS''Scardian'' ka detyrim që ta kompensoj këtë dëm në përpjesëtim me kontributin e të siguruarit të sajë në aksidentin e sipër përmendur. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertëve Dr.sci G. H. neuropsikiatër dhe Dr.Xh. S. ortoped traumatolog gjykata ka vërtetuar se paditësi si pasojë aksidentit të sipër përmendur ka pësuar edhe dëm material në formë të ndihmës dhe kujdesit të huaj, ushqimit të përforcuar në kohëzgjatje të specifikuar si në këtë aktgjykim, Kurse e paditura KS''Scardian'' ka detyrim që ta kompensoj këtë dëm në përpjesëtim me kontributin e të siguruarit të sajë në aksidentin e sipër përmendur.

Më tej ka theksuar se: Gjykata e ka detyruar të paditurën Kompania e sigurimeve ''Elsig '' që paditësit në emër të dhimbjes fizike , frikës, shëmtimit, zvogëlimit të aktivitetit jetësorë t'ia paguaj shumat si në pikën I të disozitivit të këtij aktgjykimi edhe atë nga këto arsye : aksidentit të sipër përmendur në mes të automjetit D [O. Z.] dhe automjetit C [O. V.]i ka kontribuar edhe shoferi i automjetit D, i cili shpejtësinë e lëvizjes së mjetit të tij nuk ia kishte përshtat kushteve të rrugës[me dukshmëri të zvogëluar ,për shkak të mjegullës]si dhe duke mos mbajtur distancë të nevojshme të sigurisë mbrapa automjetit C, me pjesën e përparme të automjetit të tij përplasat në pjesën e pasme të majtë të automjetit C i cili paraprakisht ishte aksidentuar me automjetin B, pran nga gjendja e vërtetuar rezulton se kontributi i të siguruarit të të paditurës KS''Elsig'' në aksidentin në fjalë ishte në shkallën prej 30 %. Kurse gjykata nga konstatimi dhe mendimi i ekspertëve mjekësore Dr.sci G. H. neuropsikiater dhe Dr. Xh. S. ortoped traumatolog ka konstatuar se paditësi si pasojë e aksidentit të sipër përmendur ka pësuar dëm jomaterial në formë dhimbjeve fizike, frikës, shëmtimit, zvogëlimit të aktivitetit jetësorë ashtu siç është përshkruar në arsyetimin e këtij aktgjykimi. Kurse e paditura KS''Elsig '' ka detyrim që ta kompensoj këtë dëm në përpjesëtim me kontributin e të siguruarit të sajë në aksidentin e sipër përmendur.

Më tej ka theksuar se: Baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit sa i përket dëmit jo material qëndron në neni 183 të LMD-së, së Kosovës, me të cilën dispozitë është paraparë '' Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Kurse gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së dëmit jomaterial dhe refuzimit të pjesës tjetër të kërkesëpadisë për dëm jo material është bazuar në kriteret e parapara me të paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së me të cilën dispozitë është paraparë '' Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror''. Kurse sa i përket dëmit material gjykata është bazuar: Në nenin 136 paragrafin 1 të LMD-së është paraparë '' Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij''. Në nenin 173 paragrafi 1 i LMD-së me të cilën është paraparë '' 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. Në nenin 174 i LMD-së me të

cilën është paraparë Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 par. 2 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452.5, 454.1, 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, por nuk përmban as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Baza juridike e kërkesëpadisë ka qenë kontastuese në kuptim të ndarjes së përgjegjësisë, por gjykata e shkallës së parë, nga provat e administruara me të drejtë ka ndarë përgjegjësinë në mes të paditurave në lartësinë 70% me 30%, kjo duke u bazuar në konstatimin e ekspertit të komunikacionit, ndërsa për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë është mbështetur në ekspertizat mjekësore.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurave për kompensimin e dëmit është në lartësinë 70% me 30% gjë që është vërtetuar nga ekspertiza e komunikacionit të ekspertit B. L. e datës 17.11.2021, si dhe mendimi plotësues lidhur me ekspertizën e aksidentit të Komunikacionit, e datës 19 nëntor 2021 i cili ka konstatuar se lëshimet primare në shkaktimin e aksidentit janë të të siguarit të të paditurave KS. “Scardian”, ndërsa lëshimet sekondare janë të të siguarve të të paditurës “Elsig”.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material, për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertëve mjeko-ligjor Dr. Xh. S. ortoped - traumatolog dhe Dr. H. neuropsikiatër, për të gjitha elementet e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, frikën e përjetuar, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shkallën e shëmtimit truporë etj. dhe se kompensimi i dëmit

jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e aprovuara për dëmin jo materiale dhe material, janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditësit dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, shkallën e shëmtimit truporë si dhe shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve mjeko-ligjor, Dr. Xh. S. ortoped - traumatolog dhe Dr. G.. H. neuropsikiatër. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e të paditurave në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që “ *kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, kurse me dispozitën e nenit 159.1 të LMD-së, i cili parasheh që “ *në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit*” ndërsa sipas nenit 183 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që “ *Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që “ *Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Andaj, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur në lidhje me kompensimin e dëmit material, ndihmën dhe kujdesin e huaj si dhe ushqimin e përforcuar, pasi që shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar si dhe ndihmën e personit të tret, janë adekuate dhe i përshtaten natyrës së

lëndimeve si dhe kohëzgjatjes së rehabilitimit të të dëmtuarit. Fakti që për këtë kategori të dëmit nuk është ofruar prova materiale, gjykata e Apelit vlerëson se edhe për kundër mos ofrimit të provave për këtë kategori të dëmit, dëmi është shkaktuar dhe se paditësit është fakt i pa kontestueshëm se të njëjtit i janë nevojitur ushqim i përforcuar dhe ndihma e personit të tretë pasi që një gjë e tillë janë konstatuar edhe në ekspertizat e cekura si më lartë.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet e të paditurës KS. “Scardian” në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë 60% me 40%, por të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë pasi që gjykata e shkallës së parë ndarjen e përgjegjësisë në lartësinë prej 70% me 30% e ka bazuar në ekspertizën e komunikacionit, pasi që eksperti në mënyrë profesionale ka specifikuar se i siguruari i të paditurës “Scardian” me seli në Prishtinë ka përgjegjësi primare, duke i listuar edhe shkeljet që janë ndërmarrë nga i njëjti e që gjykatës së shkallës së parë por edhe të gjykatës së Apelit i rezulton me përgjegjësi prej 70% duke pas parasysh natyrën e veprimeve të të siguarit të KS. “Skardian” dhe ndikimi i këtyre lëshimeve në shkaktimin e aksidentit.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësve në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së si dhe tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës, kjo për faktin se sipas tarifës së odës së avokatëve të Kosovës është paraparë që në kontestet kur vlera e kontestit është mbi 10,000.00 euro shuma për përfaqësim për seancë për dy të paditëse është shuma prej 405.60 euro dhe se ndarja e shpenzimeve nga gjykata e shkallës së parë e vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, është në pajtueshmëri të plot me ndarjen e përgjegjësisë së të paditurave.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr. 1891/2022, me datë 12.03.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v